



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 27 shkurt 2024
Policia e Shtetit – Finalizohet operacioni policor i koduar “Rishtas”

DVP Durrës – Vihen në pranga 2 shtetas, për vepra të ndryshme penale
DVP Shkodër – Procedohen në gjendje të lirë 5 shtetas dhe punohet për kapjen e 2 të tjerve, autorë të dyshuar për vepra penale të ndryshme
Elbasan – Kreu parakalim të gabuar, ndëshkohet administrativisht drejtuesi i automjetit



27/02/2024

DVP Fier – Procedohen Në Gjendje Të Lirë 6 Shtetas, Për Vepra Penale Të Ndryshme

Specialistët e Sektorit të Policisë Rrugore të DVP Fier referuan materialet në Prokurori, në gjendje të lirë, për shtetasin J. L., 30 vjeç, banues në fshatin Varibob, pasi duke drejtuar automjetin, ka humbur kontrollin dhe për pasojë automjeti ka dalë nga rruga. Nga aksidenti është dëmtuar shtetasi J. L., i cili ndodhet në spital, në kujdesin e mjekëve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Fier referuan materialet në Prokurori, në gjendje të lirë, për shtetasit:
Xh. M., 39 vjeç, banues në Fier, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij, e cila u pajis me urdhër mbrojtjeje;
A. K., 49 vjeç, banues në Fier, pasi ka goditur me grushte, një shtetas 26-vjeçar, për motive të dobëta.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lushnjë referuan materialet në Prokurori, në gjendje të lirë për shtetasit:

K. T., 46 vjeç, banues në fshatin Çanakaj, Lushnjë, pasi dyshohet se është autor i vjedhjes në një banesë, kryer në muajin nëntor 2023;

A. P., 59 vjeç, banues në fshatin Toshkëz, Lushnjë, pasi dyshohet se ka qëlluar qenin e vëllait të tij, me një armë gjahu që e mban me leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Divjakë referuan materialet në Prokurori, në gjendje të lirë, për shtetasin D. T., 50 vjeç, banues në fshatin Çermë Shkumbin, Divjakë, pasi u konstatua nga shërbimet e Policisë, duke kryer punime ndërtimi në tokën e tij, pa lejen përkatëse.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Elbasan – Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë, për vepra penale të ndryshme

DVP Korçë – Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale ▶